ANEKS C - TERMAT E REFERENCËS (ToR)

Procedurë prokurimi për kontraktimin e shërbimeve të ekspertizës së jashtme
Projekti: "RISTOR – Rural Innovation Centres for Sustainable and Inclusive Tourism"
Programi Interreg VI-A IPA Greqi–Shqipëri 2021–2027
Autoriteti Kontraktor: Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)

Ky dokument përbën Aneks të Kërkesës për Oferta dhe përshkruan fushën e punës, output-et, indikatorët e performancës, profilin e kërkuar dhe kriteret e vlerësimit për secilin LOT.

LOT 1 – Ekspert i jashtëm për menaxhim dhe koordinim të projektit

Deliverable: D.1.2
Buxheti indikativ maksimal: 4,000 EUR (përfshirë të gjitha kostot dhe taksat e aplikueshme).

1. Hyrje

Projekti RISTOR synon krijimin e dy Qendrave të Inovacionit Rural për Turizëm të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës në Demati (Greqi) dhe Dardhë (Shqipëri), duke fuqizuar aktorët lokalë përmes programeve të trajnimeve, rrjetëzimit dhe zhvillimit të modeleve të reja të shërbimeve turistike, në përputhje me parimet e aksesueshmërisë, mos-diskriminimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Observatori, si partner i projektit, kontrakton shërbime të ekspertizës sipas rezultateve përkatëse.

2. Qëllimi i kontratës

Të ofrojë mbështetje profesionale për menaxhimin dhe koordinimin operacional të zbatimit të projektit në nivel partneri (Observatori), duke siguruar zbatim në kohë, dokumentim të plotë dhe përputhshmëri me kërkesat e Programit Interreg dhe FLC (First Level Control-Kontrolli i Nivelit të Parë).

3. Fusha e punës dhe detyrat kryesore

- Rishikim i planit të punës dhe kalendarit të aktiviteteve të partnerit; propozim i një plani operacional.
- Ndjekje periodike e progresit (të paktën mujore).
- Mbështetje për përgatitjen e materialeve për takime koordinuese me partnerët (agjenda, minuta, lista veprimesh).
- Kontribut në përgatitjen e raporteve të progresit/implementimit dhe paketave të dokumentimit për FLC (në bashkëpunim me stafin e Observatorit).
- Kontroll cilësie i dokumentacionit të output-eve të partnerit (përputhshmëri me deliverable-t dhe evidencat).

4. Rezultatet e pritshme

1. Plan operacional i përditësuar (me afate, përgjegjësi).
2. Të paktën 4 raporte periodike progresi (shkurt, 2–3 faqe secili) gjatë periudhës së kontratës.
3. Paketa e dokumentimit për FLC për periudhën e mbuluar (checklist + evidenca të organizuara).
4. Raport përfundimtar i kontratës (përmbledhje e progresit, sfidat, rekomandime).

5. Indikatorët e performancës

- 100% e raporteve të dorëzuara brenda afateve të dakorduara.

- Dokumentacion i plotë dhe i organizuar për FLC (pa kërkesa të përsëritura për plotësim).

6. Kohëzgjatja dhe afatet

Kohëzgjatja: brenda periudhës së zbatimit të projektit (deri në 12.10.2027). Afatet konkrete të angazhimit dhe dorëzimeve do të përcaktohen në kontratë dhe planin e veprimit.

7. Raportimi dhe koordinimi

- Raporton tek Menaxheri/Koordinatori i Projektit pranë Observatorit.
- Komunikimi kryesor: email + takime online sipas nevojës.

8. Profili i kërkuar/ Kualifikimet

- Diplomë universitare (preferohet Master) në ekonomi, shkenca sociale, administrim publik ose fusha të ngjashme.
- Të paktën 3 vite përvojë në menaxhim/koordinim projektesh të financuara nga BE (Interreg, IPA, Horizon, etj.) ose donatorë ndërkombëtarë.
- Njohuri praktike mbi kërkesat e raportimit dhe dokumentimit (përfshirë evidencat, minuta, lista pjesëmarrësish, deliverable tracking).
- Aftësi shumë të mira organizative, shkrimi dhe komunikimi; përvojë me punë me shumë aktorë.
- Njohuri e gjuhës angleze (B2 ose më lart) – e preferueshme.

9. Përmbajtja e ofertës

Oferta duhet të përmbajë gjithë *dokumentet e listuar në pikën 8* të Thirrjes Kërkesë për Ofertë "Procedurë prokurimi për kontraktimin e shërbimeve të ekspertizës së jashtme për zbatimin e aktiviteteve të projektit RISTOR".

10. Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke kombinuar vlerësimin teknik dhe atë financiar.

Kriteri	***Përshkrimi***	***Pikët***
Metodologjia dhe plani i punës	Qartësia e qasjes, instrumentet e monitorimit, planifikimi dhe menaxhimi i riskut.	30
Përvoja relevante	Përvojë në projekte të financuara nga BE/Interreg dhe menaxhim raportimi/monitorimi.	25
Kualifikimet dhe aftësitë	Arsimi, aftësitë organizative, komunikimi, njohja e gjuhës.	15
Oferta financiare	Vlera dhe arsyetueshmëria e kostos kundrejt shërbimit të ofruar.	30

11. Pagesat dhe kushtet e pranimit

- Pagesa në këste, pas pranimit të deliverable-ve sipas kontratës.
- Pranimi konfirmohet me email/akt-pranim nga Menaxheri i Projektit.
- Për pagesat e shërbimeve të konsulencës kërkohet dokumentim sipas rregullave të brendshme (faturë/mandat, timesheet kur aplikohet, evidencë output-i).

LOT 2 – Ekspertë për hartimin e analizës së aktorëve dhe analizës së tregut për turizëm të qëndrueshëm (rajoni Korçë)

Deliverable(t): D.4.1 dhe D.4.2
Buxheti indikativ maksimal: 16,200 EUR (përfshirë të gjitha kostot dhe taksat e aplikueshme).

1. Hyrje

Projekti RISTOR synon krijimin e dy Qendrave të Inovacionit Rural për Turizëm të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës në Dematи (Greqi) dhe Dardhë (Shqipëri), duke fuqizuar aktorët lokalë përmes programeve të trajnimeve, rrjetëzimit dhe zhvillimit të modeleve të reja të shërbimeve turistike, në përputhje me parimet e aksesueshmërisë, mos-diskriminimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Observatori, si partner i projektit, kontrakton shërbime të ekspertizës sipas rezultateve përkatëse.

2. Qëllimi i kontratës

Të prodhojë dy raporte analitike – (i) analizë e aktorëve (stakeholder mapping) dhe (ii) analizë e tregut – që informojnë mundësitë e zhvillimit dhe orientimin e aktiviteteve të projektit në rajonin e Korçës, me fokus turizmin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

3. Fusha e punës dhe detyrat kryesore

- Hartim i metodologjisë së punës (burimet, mjetet e mbledhjes së të dhënave, plan intervistash/pyetësorësh).
- Identifikim dhe segmentim i aktorëve sipas sektorëve (publik/ privat/ OJF/ komunitet).
- Kryerje e konsultimeve sipas metodologjisë dhe dokumentim i evidencave.
- Analizë e trendeve turistike, segmenteve të konsumatorëve, kërkesës/ofertës, sezonalitetit, çmimeve, kanaleve të tregut.
- Identifikim i boshllëqeve të shërbimeve dhe mundësive për produkte/eksperienca të reja (p.sh. familjare, rurale, agro-, aventurë).
- Hartim rekomandimesh të aplikueshme për aktivitetet e trajnimit dhe planifikimit lokal.

4. Rezultatet e pritshme

- ***Deliverable D.4.1:***
  - Raport ‘Stakeholder Mapping’ (min. 20 faqe) me hartë aktorësh, role, interesa, ndikim dhe rekomandime angazhimi.
- ***Deliverable D.4.2:***
  - Raport ‘Market Analysis’ (min. 20 faqe) me analizë tregu, trende, segmente, konkurencë dhe potencial zhvillimi.
  - Dataset/Annex: lista e aktorëve të kontaktuar, instrumentet e përdorura (pyetësor/intervistë), përmbledhje të konsultimeve.
  - Prezantim (PPT, 10–15 slide) i gjetjeve kryesore për përdorim në aktivitete/ komunikim.

5. Indikatorët e performancës

- Të paktën 30 aktorë të identifikuar dhe të dokumentuar në hartën e aktorëve.
- Raportet përfshijnë rekomandime të zbatueshme (minimum 10 rekomandime të qarta) të lidhura me aktivitetet e projektit.
- Raportet dorëzohen në format të editueshëm (Word/Excel) + PDF, brenda afateve të dakorduara.

6. Kohëzgjatja dhe afatet

Kohëzgjatja e parashikuar do të jetë në përputhje me kalendarin e projektit. Afatet finale do të përcaktohen në kontratë dhe planin e punës.

7. Raportimi dhe koordinimi

- Raporton tek Menaxheri i Projektit pranë Observatorit.
- Kryen të paktën 1 takim fillestar (kick-off) dhe 1 takim validimi të gjetjeve (draft review).
- Draft-raportet i dorëzohen Observatorit për komente; versionet finale dorëzohen pas integrimit të komenteve.

8. Profili i kërkuar/ Kualifikimet

- Ekip/ekspert me diplomë universitare në ekonomi, shkenca sociale, administrim publik ose fusha të ngjashme.
- Përvojë e provuar (min. 3 vite) në kërkim/analiza tregu dhe/ose hartëzimin e palëve të interesit në sektorin e turizmit/zhvillimit lokal.
- Aftësi për mbledhje dhe analizë të të dhënave (cilësore dhe sasiore) dhe shkrim raportesh analitike.
- Njohje e kontekstit të turizmit në Shqipëri (preferohet rajoni Korçë) dhe kuadrit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Njohuri e gjuhës angleze (e preferueshme) për harmonizim me materialet e projektit.

9. Përmbajtja e ofertës

Oferta duhet të përmbajë gjithë *dokumentet e listuar në pikën 8* të Thirrjes Kërkesë për Ofertë "Procedurë prokurimi për kontraktimin e shërbimeve të ekspertizës së jashtme për zbatimin e aktiviteteve të projektit RISTOR".

10. Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke kombinuar vlerësimin teknik dhe atë financiar.

Kriteri	***Përshkrimi***	***Pikët***
Metodologjia dhe dizajni kërkimor	Cilësia e metodologjisë, realizueshmëria, mjetet e mbledhjes së të dhënave.	30
Përvoja dhe raporte e ngjajshme	Projekte të ngjashme në turizëm/ analiza tregu/hartëzim aktorësh.	25
Cilësia e ekipit	Kualifikimet, rolet dhe kapacitetet kërkimore/ analitike.	15
Oferta financiare	Kosto e arsyetuar dhe konkurruese kundrejt output-eve.	30

11. Pagesat dhe kushtet e pranimit

- Pagesa në këste, pas pranimit të deliverable-ve sipas kontratës.
- Pranimi konfirmohet me email/akt-pranim nga Menaxheri i Projektit.
- Për pagesat e shërbimeve të konsulencës kërkohet dokumentim sipas rregullave të brendshme (faturë/mandat, timesheet kur aplikohet, evidencë output-i).

LOT 3 – Hartim dhe zbatim i programit të trajnimit për turizëm të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës

Deliverable(t): D.4.5 dhe D.5.2
Buxheti indikativ maksimal: 11,300 EUR (përfshirë të gjitha kostot dhe taksat e aplikueshme).

1. Hyrje

Projekti RISTOR synon krijimin e dy Qendrave të Inovacionit Rural për Turizëm të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës në Dematі (Greqi) dhe Dardhë (Shqipëri), duke fuqizuar aktorët lokalë përmes programeve të trajnimeve, rrjetëzimit dhe zhvillimit të modeleve të reja të shërbimeve turistike, në përputhje me parimet e aksesueshmërisë, mos-diskriminimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Observatori, si partner i projektit, kontrakton shërbime të ekspertizës sipas rezultateve përkatëse.

2. Qëllimi i kontratës

Të dizajnojë dhe zbatojë një program trajnim kapacitetesh 4–6 mujor për aktorët lokalë të turizmit, me fokus aksesueshmërinë, gjithëpërfshirjen dhe praktikat e turizmit të qëndrueshëm, duke rritur aftësitë për ofrimin e shërbimeve cilësore.

3. Fusha e punës dhe detyrat kryesore

- Analizë e nevojave për trajnim (përdorim i gjetjeve nga LOT 2 ose konsultime të shkurtra).
- Hartim i kurrikulës së trajnimit dhe planit të sesioneve (modulet, objektivat mësimore, kohëzgjatja, mjetet).
- Përgatitje e materialeve të trajnimit (modul, slide, ushtrime, raste studimore).
- Zbatim i programit (sesione teorike + punë praktike), për një periudhë 4–6 muaj.
- Vlerësim i pjesëmarrësve: test vlerësues para dhe pas trajnimit, evidentim i pjesëmarrjes.

4. Rezultatet e pritshme

- ***Deliverable D.4.5:***
  - Program i dokumentuar trajnimi (kurrikula, plan sesionesh, metodologji).
  - Paketa e materialeve të trajnimit (PPT, fletë pune, raste studimore, burime).
- ***Deliverable D.5.2:***
  - Raporte trajnimesh (agjenda, temat e prezantuara, vlerësimet para dhe pas trajnimit) + evidenca (lista pjesëmarrjeje, foto, postime në mediat sociale).

5. Indikatorët e performancës

- Minimum 6 sesione trajnimi të realizuara (ose ekuivalente në orë), sipas planit të dakorduar.
- Minimum 60 pjesëmarrës të angazhuar gjatë programit (totali mund të rregullohet sipas planit të projektit).
- Minimum 60% e pjesëmarrësve tregojnë përmirësim në vlerësimin e kapaciteteve para dhe pas trajnimit.

6. Kohëzgjatja dhe afatet

Kohëzgjatja: 4–6 muaj nga nënshkrimi i kontratës, në përputhje me kalendarin e projektit. Afatet e sesioneve do të dakordohen me Observatorit dhe aktorët lokalë.

7. Raportimi dhe koordinimi

- Raporton tek Menaxheri i Projektit pranë Observatorit.
- Dorëzon planin e trajnimit për aprovim përpara nisjes së sesioneve.
- Dorëzon raporte mujore të shkurtra (1–2 faqe) mbi progresin dhe pjesëmarrjen (opsionale, nëse kërkohet).

8. Profili i kërkuar/ Kualifikimet minimale

- Ekspert/ trajner me diplomë universitare në ekonomi, shkenca sociale, administrim publik ose fusha të ngjashme.
- Të paktën 3 vite përvojë në hartim modulesh për ngritje dhe forcim kapacitetesh dhe realizim trajnimesh për turizëm apo/dhe zhvillim komunitar.
- Përvojë e dokumentuar në tema të aksesueshmërisë, gjithëpërfshirjes, shërbimit ndaj klientit dhe/ose standardeve të qëndrueshmërisë.
- Aftësi shumë të mira trajnimi dhe përgatitje materialesh didaktike.
- Njohuri e gjuhës angleze (e preferueshme) për përdorim të materialeve të projektit.

9. Përmbajtja e ofertës

Oferta duhet të përmbajë gjithë *dokumentet e listuar në pikën 8* të Thirrjes Kërkesë për Ofertë "Procedurë prokurimi për kontraktimin e shërbimeve të ekspertizës së jashtme për zbatimin e aktiviteteve të projektit RISTOR".

10. Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke kombinuar vlerësimin teknik dhe atë financiar.

Kriteri	***Përshkrimi***	***Pikët***
Cilësia e kurrikulës dhe metodologjisë	Struktura, relevanca, qasja gjithëpërfshirëse dhe mënyra e vlerësimit.	35
Përvoja në trajnim dhe tema	Referenca dhe projekte të ngjashme në turizëm/ zhvillim.	20
Aftësitë e ekipit/trajnerit	Facilitim, komunikim, prodhim materialesh; disponueshmëri.	15
Oferta financiare	Kosto e arsyetuar dhe konkurruese.	30

11. Pagesat dhe kushtet e pranimit

- Pagesa në këste, pas pranimit të deliverable-ve sipas kontratës.
- Pranimi konfirmohet me email/akt-pranim nga Menaxheri i Projektit.
- Për pagesat e shërbimeve të konsulencës kërkohet dokumentim sipas rregullave të brendshme (faturë/mandat, timesheet kur aplikohet, evidencë output-i).

LOT 4 –Zhvillim i modeleve të biznesit dhe planit lokal të veprimit

Deliverable(t): D.4.3 dhe D.5.1
Buxheti indikativ maksimal: 9,000 EUR (përfshirë të gjitha kostot dhe taksat e aplikueshme).

1. Hyrje

Projekti RISTOR synon krijimin e dy Qendrave të Inovacionit Rural për Turizëm të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës në Demati (Greqi) dhe Dardhë (Shqipëri), duke fuqizuar aktorët lokalë përmes programeve të trajnimeve, rrjetëzimit dhe zhvillimit të modeleve të reja të shërbimeve turistike, në përputhje me parimet e aksesueshmërisë, mos-diskriminimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Observatori, si partner i projektit, kontrakton shërbime të ekspertizës sipas rezultateve përkatëse.

2. Qëllimi i kontratës

Të zhvillojë modele praktike (raste biznesi) të shkallëzueshme për turizëm të qëndrueshëm dhe të mbështesë aktorët lokalë në hartimin e planeve të veprimit gjithëpërfshirëse, të aplikueshme në rajonin e Korçës dhe të transferueshme ndërkufitarisht.

3. Fusha e punës dhe detyrat kryesore

- Përzgjedhje dhe dokumentim i rasteve të biznesit (business cases) që demonstrojnë praktika të mira në turizëm të qëndrueshëm.
- Hartim i një formati standard për rastet e biznesit (problemi, zgjidhja, modeli i të ardhurave, kosto, ndikim social/mjedisor, transferueshmëri).
- Facilitim i aktiviteteve me aktorët lokalë për të identifikuar iniciativa dhe për të hartuar plane veprimi.
- Mbështetje mentorimi për grupet/pjesëmarrësit gjatë hartimit të planeve.
- Integrim i masave për grupe vulnerabël dhe elementëve të aksesueshmërisë.

4. Rezultatet e pritshme

- ***Deliverable D.4.3:***
  - Paketë me raste biznesi (minimum 3 raste) në format të standardizuar + përmbledhje ekzekutive.
- ***Deliverable D.5.1:***
  - Plan lokal veprimi i strukturuar me objektiva, aktivitete, afate, burime dhe indikatorë.
  - Raport i aktiviteteve (lista pjesëmarrjeje, minuta, foto, feedback).
  - PPT prezantimi i rasteve të biznesit dhe planit (10–15 slide).

5. Indikatorët e performancës

- Tre raste biznesi të dorëzuara dhe të validuara nga Observatori.
- Një plan veprimi i dorëzuar, i realizueshëm dhe me indikatorë.

6. Kohëzgjatja dhe afatet

Kohëzgjatja e parashikuar do të jetë në përputhje me kalendarin e projektit. Afatet finale do të përcaktohen në kontratë dhe planin e punës.

7. Raportimi dhe koordinimi

- Raporton tek Menaxheri i Projektit pranë Observatorit.
- Siguron validim të strukturës së rasteve/planit përpara dorëzimit final.

8. Profili i kërkuar/ Kualifikimet minimale

- Ekspert/ekip me diplomë universitare në ekonomi, shkenca sociale, administrim publik ose fusha të ngjashme.
- Të paktën 3 vite përvojë në zhvillim modelesh biznesi, plane veprimi ose projekte zhvillimi lokal.
- Njohje e koncepteve të turizmit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës; aftësi për të integruar masa për grupe vulnerabël.
- Aftësi të mira shkrimi dhe strukturimi dokumentesh.

9. Përmbajtja e ofertës

Oferta duhet të përmbajë gjithë *dokumentet e listuar në pikën 8* të Thirrjes Kërkesë për Ofertë "Procedurë prokurimi për kontraktimin e shërbimeve të ekspertizës së jashtme për zbatimin e aktiviteteve të projektit RISTOR".

10. Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke kombinuar vlerësimin teknik dhe atë financiar.

Kriteri	***Përshkrimi***	***Pikët***
Qasja dhe metodologjia	Formati i rasteve, logjika e planeve, integrimi i gjithëpërfshirjes.	35
Përvoja në hartime projekte zhvillimi lokal	Referenca të ngjashme dhe rezultate të provuara.	20
Facilitim dhe mentorim	Aftësi për punë me komunitetin dhe aktorët lokalë.	15
Oferta financiare	Kosto e arsyetuar dhe konkurruese.	30

11. Pagesat dhe kushtet e pranimit

- Pagesa në këste, pas pranimit të deliverable-ve sipas kontratës.
- Pranimi konfirmohet me email/akt-pranim nga Menaxheri i Projektit.
- Për pagesat e shërbimeve të konsulencës kërkohet dokumentim sipas rregullave të brendshme (faturë/mandat, timesheet kur aplikohet, evidencë output-i).

LOT 5 – Shërbime ekspertize për evente rrjetëzimi dhe mbështetje për platformën e turizmit

Deliverable(t): D.5.3 dhe D.5.4
Buxheti indikativ maksimal: 12,900 EUR (përfshirë të gjitha kostot dhe taksat e aplikueshme).

1. Hyrje

Projekti RISTOR synon krijimin e dy Qendrave të Inovacionit Rural për Turizëm të Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës në Dematи (Greqi) dhe Dardhë (Shqipëri), duke fuqizuar aktorët lokalë përmes programeve të trajnimeve, rrjetëzimit dhe zhvillimit të modeleve të reja të shërbimeve turistike, në përputhje me parimet e aksesueshmërisë, mos-diskriminimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Observatori, si partner i projektit, kontrakton shërbime të ekspertizës sipas rezultateve përkatëse.

2. Qëllimi i kontratës

Të ofrojë ekspertizë teknike dhe organizative për planifikimin dhe zbatimin e eventeve të rrjetëzimit (lokale dhe ndërkufitare), si dhe mbështetje helpdesk për platformën e turizmit, duke lehtësuar komunikimin dhe ndarjen e burimeve mes aktorëve.

3. Fusha e punës dhe detyrat kryesore

- Planifikim i eventeve: koncept, agjendë, target grup, ftesa, regjistrimi dhe koordinimi logjistik.
- Organizim/facilitim i sesioneve të rrjetëzim (format, moderim, dokumentim).
- Angazhimi i ekspertëve teknikë për mbështetje.
- Mbështetje për përdoruesit e platformës (udhëzues, përgjigje pyetjeve).
- Përgatitje e materialeve të eventit dhe dokumentim i rezultateve.

4. Rezultatet e pritshme

- ***Deliverable D.5.3:***
  - Raporte për eventet e rrjetëzimit me agjenda, lista pjesëmarrësish, minuta dhe rezultatet kryesore.
- ***Deliverable D.5.4:***
  - Raport i shërbimit helpdesk/platformë (statistika përdorimi, pyetje të shpeshta, përmirësime të sugjeruara).
  - Paketa evidencash: foto, materiale komunikimi, linke/posta, lista kontakti (kur është e lejueshme).
  - Udhëzues i shkurtër për përdorimin e platformës.

5. Indikatorët e performancës

- Takime të realizuara dhe të dokumentuara sipas kërkesave.
- Dokumentimi i pjesëmarrësve në aktivitete.

6. Kohëzgjatja dhe afatet

Kohëzgjatja e parashikuar do të jetë në përputhje me kalendarin e projektit. Afatet finale do të përcaktohen në kontratë dhe planin e punës.

7. Raportimi dhe koordinimi

- Raporton tek Menaxheri i Projektit pranë Observatorit.
- Koordinon me partnerët për pjesëmarrësit ndërkufitarë dhe komunikimin.

- Dorëzon raporte brenda 10 ditëve pune pas çdo eventi.

8. Profili i kërkuar/ Kualifikimet minimale

- Ekspert/kompani me përvojë në organizim eventesh profesionale dhe facilitim rrjetëzimi (min. 3 vite).
- Përvojë në komunikim/komunitete profesionale, evente për SME ose turizëm (e preferueshme).
- Kapacitete teknike për mbështetje platformash (helpdesk, udhëzues përdorimi, menaxhim kërkesash).
- Aftësi shumë të mira organizative, komunikim në shqip; njohje e anglishtes e preferueshme.
- Disponueshmëri për punë në terren dhe koordinim online.

9. Përmbajtja e ofertës

Oferta duhet të përmbajë gjithë *dokumentet e listuar në pikën 8* të Thirrjes Kërkesë për Ofertë "Procedurë prokurimi për kontraktimin e shërbimeve të ekspertizës së jashtme për zbatimin e aktiviteteve të projektit RISTOR".

10. Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke kombinuar vlerësimin teknik dhe atë financiar.

Kriteri	***Përshkrimi***	***Pikë t***
Plani i eventeve dhe metodologjia	Struktura e eventeve, menaxhim regjistrimi dhe dokumentimi.	30
Kapaciteti teknik për platformën/helpdesk	Qasja për mbështetje, udhëzues, menaxhim kërkesash.	20
Përvoja dhe referencat	Evente të ngjashme, komunitete profesionale, projekte ndërkombëtare.	20
Oferta financiare	Kosto e arsyetuar dhe konkurruese.	30

11. Pagesat dhe kushtet e pranimit

- Pagesa në këste, pas pranimit të deliverable-ve sipas kontratës.
- Pranimi konfirmohet me email/akt-pranim nga Menaxheri i Projektit.
- Për pagesat e shërbimeve të konsulencës kërkohet dokumentim sipas rregullave të brendshme (faturë/mandat, timesheet kur aplikohet, evidencë output-i).